

# Parajsa e Fshehur – Ekonomia e fshehur dhe Shmangia e taksave në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë

## Raporti i politikave Nr.39 Prill 2017

### 1. Hyrje

Praktikat e ekonomisë së fshehur nuk janë gjithmonë, siç sugjeron emri, aktivitete të profilit të ulët në ekonomi. Rrjedhja e të dhënave nga “Panama Papers” ka nxjerrë në pah një matricë të evazionit të taksave të nivelit të lartë, që ka fshehur një shumë të konsiderueshme të ardhurash drejt vendeve të Bashkimit Europian dhe ka privuar kryerjen e shumë shërbimeve publike, të cilat duhet t’i ofronin qeveritë. Është e qartë, që ka më shumë nevojë për një transparencë ndërkufitare dhe ndërveprim ndërkombëtar në mënyrë që të merremi me këtë problem, teksa ekonomia e fshehur dhe praktikat e evazionit fiskal janë një dukuri globale, pavarësisht se kanë karakter lokal. Gjithsesi, duke pasur parasysh që disa shtete të BE-së (Irlanda, Luksemburgu) që njihen si parajsa fiskale, janë të orientuara nga vetë-interesi, një lëvizje e menjëhershme në sistemin e taksave të BE-së do të krijonte probleme.

Sipas të dhënave të vitit 2013, të raportuara nga Reuters, Bashkimi Europian humb çdo vit rreth 1 trilion euro në të ardhura publike, për shkak të evazionit dhe mashtrimit.<sup>1</sup> Duke marrë në konsideratë që Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) i Bashkimit Europian ishte rreth 12.7 trilionë dollarë në 2013-n, evazoni i taksave

<sup>1</sup> Francois, Lenoir, *BE humb 1 trilion euro në vit nga shmangia e taksave*. Reuters (21.03.2013). Marrë nga: <http://www.reuters.com/article/2013/04/12/us-eu-tax-vanrompuy-idUSBRE93B0KC20130412>

### Gjetjet kryesore

- Moslëshimi i kuponit tatimor dhe evazoni tatimor në Maqedoni janë dy arsyt kryesore që kanë ndikuar në gjetjen e parregullsive nga organet tatimore në periudhën 2006-2016 (PRO).
- Përqindja më e lartë e shërbimeve të pataksuara është në Kosovë (74%), e dyta në Shqipëri (65%) dhe e treta në Maqedoni (54%).
- Përqindja e të anketuarve që pohojnë se nuk kanë marrë një faturë/kupon tatimor pasi kanë blerë një produkt të caktuar në Kosovë është 57.1%, Shqipëri 43%, dhe më e ulëta me 11.8% të të anketuarve në Maqedoni (Error! Reference source not found.).
- Të ardhurat buxhetore në Maqedoni janë 29% e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) në 2016, dhe në Shqipëri e Kosovë nga 27%. Ato janë shumë më të ulëta se mesatarja e BE-së prej 45% të PBB-së.
- Mos lëshimi i kuponit tatimor për mallrat e akcizës, alkool dhe cigare (Figura 8) në 2016 pothuajse është dyfishuar në Maqedoni në 20%. Kjo përqindje është më e përkeqësuar në Shqipëri (52%) dhe

dhe mashtrimi përfaqësonin rreth 7.9% të PBB-së vjetore në 2013. Nëse këtë përqindje e përdorim për të vlerësuar evazionin në vendet jo anëtare të BE-së, ndonëse mund të jetë e nënvlerësuar, sërish është e dobishme për shkallën dhe kontrastin që ajo jep.

është sa dyfishi i buxhetit të saj vjetor të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Shqipëria humb potencialisht rreth 810 milionë euro në vit, ose 6 herë më shumë se buxheti i saj i mbrojtjes. Kosova humb më shumë se 470 milionë euro në vit, që është e barabartë me më shumë se 7 herë buxhetin vjetor të Forcave të Sigurisë së Kosovës.<sup>2</sup> Edhe pse këto shifra janë thjesht vlerësime, ato

Tabela 1 – Norma e kontributeve të sigurimeve shoqërore për periudhën (2006-2016) në Maqedoni. Burimi: KPMG (2012), Zyra e të Ardhurave Publike (PRO) (2014) dhe Trpeski, Tashevski (2012), <http://www.oeconomica.uab.ro/upload/lucrari/1420122/24.pdf>

	2006	2007	2008	2009	2010/2016
<b>Pensionet dhe kontributet për paaftësi</b>	21.2%	21.2%	21.2%	19%	18%
<b>Kontributet e sigurimeve shëndetësore</b>	9.2%	9.2%	9.2%	7,5%	7.3%
<b>Kontributet e sigurimit të papunësisë</b>	1.6%	1.6%	1.6%	1.4%	1.2%
<b>Kontribute shëndetësore shtesë në rast aksidenti në punë dhe dëmtime të ngjashme</b>				0.5%	0.5%
<b>Tatimi mbi të ardhurat personale</b>	15%	12%	10%	10%	10%
<b>Barra totale e taksave (Maqedonia)</b>	<b>47%</b>	<b>44%</b>	<b>42%</b>	<b>38,4%</b>	<b>37%</b>

ilustronë shkallën e mos realizimit të të ardhurave buxhetore dhe humbjen potenciale që shkaktohet nga mospërdorimi i këtyre të ardhurave në përmirësimin e sasisë dhe cilësisë së shërbimeve publike.

*Qeveria nuk i ka realisht burimet për të gjurmuar çdo individ ose biznes që zbaton taktika të evazionit fiskal. Ajo për të cilën qeveria mban të dhëna janë të ardhurat e humbura. Sipas të dhënave të Shërbimit të Brendshëm të të Ardhurave të SHBA-ve, rreth 500 mld USD taksa humbën vitin e kaluar për shkak të pagave të nën-deklaruara, kundrejt 384 mld USD në 2001. (CNBC, 24.04.2013)*

Të luftosh evazionin dhe mashtrimin me taksat, si pjesë e politikave që synojnë aktivitetet e ekonomisë së fshehur, nuk është vetëm një mënyrë për të rritur të ardhurat e qeverisë, por gjithashtu një mënyrë për të rritur drejtësinë e sistemit tatimor, dhe për të përmirësuar pranueshmërinë e sistemit tatimor dhe besueshmërinë mes qytetarëve dhe bizneseve, nxitjen e të drejtave të njeriut, dhe mundësimin e një mbrojtjeje të përshtatshme për shtresën më të brishtë të shoqërisë tonë.

Duke supozuar që vende në zhvillim, si Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova kanë një evazion taksash të paktën 7.9% të PBB-së së tyre, kjo nënkupton që Maqedonia humb si evazion taksash rreth 720 milionë euro në vit, shumë që

<sup>2</sup> Vlerësimet janë bërë duke llogaritur evazionin tatimor me referencë 7.9% ndaj PPB-së nominale të tre vendeve.

## 2. Tarifat tatimore, të ardhurat dhe Evazioni tatimor

Ka diferenca të mëdha në madhësinë, qëllimin dhe sektorët kryesorë të ekonomisë së padeklaruar në Europë, që sipas të dhënave të Eurofound, llogaritet në rreth “18% të PBB-së së BE-së, duke u luhatur nga poshtë 8% të PBB-së (Austria) në mbi 30% të PBB-së (Bulgaria). Puna e padeklaruar mbizotëron më së shumti në industrinë e ndërtimit, por është gjithashtu e përhapur në shërbimet shtëpiake, sigurinë private, pastrimin industrial, bujqësinë, dhe industrinë e hoteleve, restoranteve dhe kateringut.”<sup>3</sup> Në mënyrë të pashmangshme politikat dhe veçoritë ekonomike të vendit krijojnë një grup të veçantë nxitësish, të cilat më pas prodhojnë kosto dhe përfitime specifike të lidhura me ekonominë e fshehur. Zbulimi i këtyre incentivave specifike pozitive dhe negative orienton drejt politikave që synojnë zgjidhjen e

autoriteteve fiskale, ndërgjegjësimi si dhe besimi në institucionet qeverisëse.

Krahasimi i niveleve të të ardhurave tatimore ndaj PBB-së mes vendeve, jep një indikator të rëndësishëm të sektorit publik në ekonomi përse i përket disponueshmërisë së burimeve financiare dhe varësisë nga vendimet e politikave qeveritare, të marra në të shkuarën apo aktualisht. Të ardhurat e përgjithshme të qeverisë mund të përdoren gjithashtu si një tregues i aktiviteteve të padeklaruara në ekonominë informale dhe për të vlerësuar se sa i shmanget aktiviteti ekonomik mbikëqyrjes së qeverisë dhe sistemit tatimor, veçanërisht në vendet në zhvillim. **Të ardhurat tatimore të Maqedonisë ndaj PBB-së ishin 29% e PBB-së në 2016-, ato të Shqipërisë dhe Kosovës në 27%, që janë shumë më të ulëta se mesatarja e BE-së prej 45% të PBB-së (Figure 1).** Edhe pse është e kuptueshme që pjesa më e madhe e vendeve në zhvillim kanë nivel kaq të ulët të të ardhurave

	Shqipëria	Maqedonia	Kosova
<b>Kontributet e Sigurimeve Shoqërore (norma totale)</b>	27.9% (11.2% punëmarrësi, 16.7% punëdhënësi)	27% (13.5% punëmarrësi dhe 13.5% punëdhënësi)	10% (5% punëmarrësi dhe 5% punëdhënësi)
<b>Tatim fitimi</b>	15%	10%	10%
<b>TVSH</b>	20%	18%	18%
<b>Tatimi mbi të ardhurat personale</b>	Normë progresive 0%, 13% dhe 23%	Normë e sheshtë 10%	Normë progresive 0% (0-80 eur), 4% (81-250 eur) and 10% (> 450 eur)

problemeve


Evazioni fiskal është i lidhur me diferencat mes shteteve, si sistemi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore, normat tatimore, efienca e

ndaj PBB-së, është një perspektivë shqetësuese fakti që ky tregues nuk është përmirësuar gjatë 8 viteve. Për më tepër, Maqedonia ka përjetuar një përkeqësim të të ardhurave ndaj PBB-së, nga 33% në 2008 në 29% në 2016, pavarësisht ecurisë pozitive të ekonomisë, rritjes së investimeve të huaja direkte, rritjes së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe rritjes së të ardhurave nga taksat. Për Shqipërinë, raporti i të ardhurave ndaj PBB-së ka mbetur pothuajse i njëjtë në 8 vitet e fundit, ndërsa është

<sup>3</sup> Lajmet e Parlamentit European (02.02.2016) “Platforma europiane për punën e padeklaruar.” 19.07.2016  
<<http://www.europarl.europa.eu/neës/en/neës-room/20160129IPR11935/European-platform-to-tackle-undeclared-ëork>>

përmirësuar lehtë në Kosovë, nga 24% në 2008 në 27% në 2016.

Figure 1 – Të ardhurat e përgjithshme të qeverisë, si % e PBB.  
Burimi: IMF World Economic Outlook  
<https://knoema.com/IMFEO2014Apr/imf-world-economic-outlook-april-2014?tsid=1025200>



## Maqedonia

Kërkimi i Mojsoska-Blazevski (2011)<sup>4</sup>, mbi ndikimin e ndryshimit të legjislacionit të punës mbi punësimin dhe madhësinë e ekonomisë informale tregoi një efekt të vogël prej politikës së taksës së sheshtë. Autorja gjeti se **'reduktimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore kishte pasur një efekt pozitiv në normën e punësimit, në kontrast me ndikimin e reformës së taksës së sheshtë.'** Ajo arriti në përfundimin se reforma e taksave dhe e sigurimeve shoqërore që synonte në reduktimin e kostove të punës kishte dhënë efektet e mëposhtme pozitive: (a) kishte ndihmuar punonjësit gjatë krizës, (b) kishte pasur efekt në punësim, (c) kishte rritur pagën neto, (d) kishte zvogëluar madhësinë e ekonomisë informale, (e) kishte përmirësuar pagimin e taksave, dhe (f) kishte rritur numrin e individëve të siguruar në sistemin e pensioneve.<sup>5</sup>

<sup>4</sup> Dzhekova, Franic, Mishkov, C. Williams (2014), "Tackling the Undeclared Economy in FYR Macedonia" GREY Working Paper No. 3, University of Sheffield. Marrë nga: [http://www.grey-project.group.shef.ac.uk/ep-content/uploads/2014/08/WP3-Tackling-the-Undeclared-Economy-in-FYROM\\_10072014.pdf](http://www.grey-project.group.shef.ac.uk/ep-content/uploads/2014/08/WP3-Tackling-the-Undeclared-Economy-in-FYROM_10072014.pdf)

<sup>5</sup> Dzhekova, Franic, Mishkov, C. Williams (2014), "Tackling the Undeclared Economy in FYR Macedonia"

Barra totale tatimore në Maqedoni ka mbetur e ulët për periudhën 2010-2016. Gjithsesi, barra tatimore mbetet veçanërisht e lartë në disa punë që kërkojnë kualifikim të ulët, "si rrjedhojë e bazës minimale për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore, që paguhet në bazë të 65% të pagës mesatare kombëtare dhe në rreth 50% për sigurimin shëndetësor (e diferencuar sipas degëve, me barrë relativisht të lartë për degët me pagë të ulët mesatare)"<sup>6</sup>.

Nëse analizojmë të dhënat statistikore (Figura 2) që vijnë nga Zyra Publike e Të Ardhurave (PRO), ka **pasur një tendencë pozitive në të ardhurat nga taksat nga pensionet dhe kontributet e sigurimeve shoqërore**, veçanërisht që nga viti 2008 me një rritje mesatare të kontributeve totale me 4.95%. Gjithsesi, të ardhurat nga kontributet e pensioneve dhe të paftësisë dhe kontributet e punësimit nuk janë rritur në mënyrë dramatike. Në fakt, gjatë periudhës 2008-2016, të ardhurat vjetore janë rritur me një total prej 29% dhe 20% përkatësisht që nga 2008 dhe kanë mbetur në nivelet mesatare vjetore prej 29 miliardë MKD (471 mln. EUR) dhe 1.8 miliard MKD (29.2 mln. EUR) përkatësisht. Tendencë pozitive në të ardhurat totale nga kontributet e sigurimeve shoqërore ka ardhur kryesisht nga rritja e shpejtë e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shëndetësore, që në 8 vjet mëse janë dyfishuar, nga 11 miliardë MKD në 2008 në 23 miliardë MKD në 2016. Kjo ka ardhur si rrjedhojë e efekteve

GREY Working Paper No. 3, University of Sheffield. p.44-45. Marrë nga: [http://www.grey-project.group.shef.ac.uk/wp-content/uploads/2014/08/EP3-Tackling-the-Undeclared-Economy-in-FYROM\\_10072014.pdf](http://www.grey-project.group.shef.ac.uk/wp-content/uploads/2014/08/EP3-Tackling-the-Undeclared-Economy-in-FYROM_10072014.pdf)

<sup>6</sup> Trpeski P., Tashevsk B. (2012) *Labour Tax Wedge in the Republic of Macedonia – Trends and International Comparison*. Annales Universitatis Apulensis Series Oeconomica, 14(2), 2012, p.575. <http://www.oeconomica.uab.ro/upload/lucrari/142012/24.pdf>

pozitive të ndryshimeve në Ligjin për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore (LMSSC).<sup>7</sup>

Figura 2 -Të ardhurat nga taksat nga kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën (2008- 2015). Burimi: Zyra Publike e të Ardhurave të Maqedonisë.




Figura 3 -Norma e Mbledhjes së taksave në Zyrën Publike të të Ardhurave dhe Zyrën Doganore në Maqedoni (në mld. MKD). Burimi: PRO <http://ujp.gov.mk/mk/statistika/naplata/1/0/0> and Customs <http://ëëë.carina.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=57>





Figura 4 – Raportet për parregulsi në linjën direkte të raportimit të PRO (198) dhe E-report. Burimi: PRO <http://ujp.gov.mk/mk/statistika/naplata/9/0/0>




<sup>7</sup> Dzhekova, Franic, Mishkov, C. Williams (2014), “Tackling the Undeclared Economy in FYR Macedonia” GREY Working Paper No. 3, University of Sheffield. [http://www.grey-project.group.shef.ac.uk/wp-content/uploads/2014/08/WP3-Tackling-the-Undeclared-Economy-in-FYROM\\_10072014.pdf](http://www.grey-project.group.shef.ac.uk/wp-content/uploads/2014/08/WP3-Tackling-the-Undeclared-Economy-in-FYROM_10072014.pdf) p.44

## Shqipëria

Që prej vitit 1997 Shqipëria po bën përpjekje për të vendosur një sistem taksash dhe tarifash në linjë me vendet anëtare të Bashkimit Europian. Një taksë e sheshtë prej 10%, së bashku me lehtësi të tjera u zbatuan në vitin 2008, që çoi në një rritje të përgjithshme të të ardhurave tatimore, të paktën deri në vitin 2011. Gjithsesi, duhet theksuar se të ardhurat ndaj PBB-së kanë rënë ose kanë mbetur të njëjta që prej vitit 2008, në nivelin e rreth 27% të PBB-së (Figure 1). Në 2013-n, qeveria e re nënshkroi një marrëveshje tre vjeçare me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), duke siguruar cash në këmbim të detyrimit për të shtrënguar disiplinën fiskale<sup>8</sup>. Kjo mbështetje ndihmoi në përmbysjen e trendit të rënies së të ardhurave që Shqipëria përjetoi në periudhën 2011-2013, kryesisht përmes rritjes së të ardhurave që erdhën nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe nga tatim fitimi. Normat tatimore u rritën si taksë e korporatave nga 10 në 15% si dhe akciza për disa produkte kryesore. Në vitin 2014, tatimi mbi të ardhurat personale ndryshoi nga një normë e sheshtë në një sistem progresiv. Duke qenë se 60% të tatimpaguesve ishin poshtë kufirit të tatimit zero, kjo reformë dobësoi mbledhjen e taksave.

Figura 5 – Të ardhurat tatimore në Shqipëri nga kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën (2006- 2015) në mld lekë. Burimi: Ministria e Financave e Shqipërisë



Rritja e akcizës për cigaren dhe naftën në vitin 2015, nuk dha efekt në shtimin e të ardhurave. Arsyeja mund të lidhet me blerjet paraprake në pritje të rritjes së akcizës, sesa me një rënie të konsumit të këtyre mallrave. Qeveria vendosi në buxhetin e vitit 2016 të hiqte taksën për biznesin e vogël dhe të përjashtonte biznesin e vogël dhe mikro nga tatim fitimi, që do të kishte efekt negativ në buxhet, por do të nxiste aktivitetin ekonomik.<sup>2</sup> Për shkak të eficiencës së dobët tatimore, përjashtimeve të shumta tatimore dhe sfidën me mbledhjen e taksave, të ardhurat tatimore pritet të rriten lehtësisht deri në 2019.<sup>9</sup>

### Evazioni fiskal

Gjendja e evazionit fiskal në Shqipëri nuk është lehtësisht e identifikueshme, kryesisht pasi nuk ka statistika të sakta ose raporte nga institucionet përgjegjëse<sup>10</sup>. Për shkak të burokracisë dhe volumit të lartë të transaksioneve në cash, është e vështirë të mbledhësh të dhënat e nevojshme.<sup>11</sup> Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, një mënyrë

<sup>8</sup> Balkan Insight: <http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-government-starts-major-crackdown-against-fiscal-evasion-09-01-2015-sthash.Y4xeKWdm.dpuf>

<sup>9</sup> International Monetary Fund, Staff Report Albania 2016, <https://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2016/cr16142.pdf>


<sup>10</sup> Hysen Muceku, Altin Muca, 'Informal Economy in Albania – Its Costs in the Country Development' (2014) 5(9) Mediterranean Journal of Social Sciences 642, 64

<sup>11</sup> International Monetary Fund, Albania June 2016 <https://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2016/cr16143.pdf>



për të llogaritur evazionin tatimor është norma e eficiencës së TVSH-së (C-efficiency). Fondi llogaritur një hendeq prej 34-39% të TVSH-së potenciale<sup>2</sup>, që është pak më lart se mesatarja rajonale dhe ka shënuar një trend rritës që nga 2008. Të ardhurat potenciale të TVSH-së për vendet e BE-së janë 15 %. Kjo tendencë në rritje duket se është shkaktuar nga përkeqësimi i mbledhjes së kësaj takse, kryesisht për shkak kontrabandës domethënëse dhe mashtimit me akcizën në Shqipëri, si nafta dhe cigaret.

Figure 6 – Të ardhurat tatimore në Shqipëri në mld Lek. Burimi: Ministria e Financave e Shqipërisë.



Ekonomia e zezë e Shqipërisë vlerësohet të jetë në 33% të PBB-së<sup>12</sup> në 2014, një shifër që është shumë më e lartë se mesatarja europiane prej 18.6%.<sup>13</sup> Në shtator 2015, qeveria prezantoi një fushatë kundër informalitetit, që synonte të

adresonte evazionin fiskal, veçanërisht përmes kontrollit më të mirë, regjistrimit të punonjësve dhe bizneseve të vogla si dhe forcimit të pagimit të taksave. Megjithëse kishte pritshmëri të larta nga të gjithë aktorët, për shkak të ashpërsisë dhe fokusit në bizneset e vogla, ai nuk dha rezultatet e pritura dhe kontribuoi në përkeqësimin e klimës së biznesit në vend. Aktualisht, përjasja e institucioneve tatimore ka ndryshuar, duke qenë më bashkëpunues dhe duke u përqendruar kryesisht në analizën e rrezikut.

**Kompleksiteti i sistemit tatimor është një barrë e rëndë për bizneset.** Numri i pagesave të taksave dhe orëve që duhen për të paguar taksat janë përkatësisht 19 dhe 43%, përkatësisht më të larta se mesatarja e Ballkanit Perëndimor. Të ardhurat e përgjithshme buxhetore, si nga taksat ashtu dhe nga burime të tjera janë më të ulëta sesa fqinjët. Si rrjedhojë, edhe shpenzimet publike janë më të ulëta.

**Barra e taksave është më e ulët në Shqipëri sesa në pjesën më të madhe të ekonomive të Ballkanit,** të paktën deri në vitin 2014. Krahasuar me pjesën më të madhe të shteteve fqinjë, të ardhurat tatimore të Shqipërisë janë modeste për pjesën më të madhe të taksave kryesore. Në veçanti, tatimi mbi të ardhura, taksa e pasurisë dhe mbi të gjitha kontributet e sigurimeve shoqërore janë veçanërisht të ulëta në Shqipëri. Vetëm të ardhurat nga TVSH dhe tatim fitimi janë në të njëjtën linjë me atë të shteteve të tjera në krahasim. Si rrjedhojë, Shqipëria mbështetet më shumë tek taksat indirekte, sesa tek ato direkte: pesha e të ardhurave nga TVSH dhe akciza është rreth 49%.

**Të ardhurat e ulëta tatimore të Shqipërisë janë pjesërisht pasojë e eficiencës së ulët të tatimit mbi pagën** (Figure 6). Eficienca tatimore është raporti mes të ardhurave tatimore për çdo taksë (në përqindje ndaj PBB-së) dhe normës më të lartë tatimore. Eficienca tatimore për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe të ardhurave personale duket të jetë më e ulët në Shqipëri sesa në shtetet e tjera të Ballkanit. Për të ardhurat nga

<sup>12</sup> Bright Line Law: An insight into tax evasion, money laundering and the Albanian black economy 2016 (<https://www.brightlinelaw.co.uk/Latest-News/An-insight-into-tax-evasion-money-laundering-and-the-albanian-black-economy-1.html>)

<sup>13</sup> Shadow Economy and Tax Evasion in the EU, Schneider 2014 (<http://www.econ.jku.at/members/Schneider/files/publications/2015/JournalofMoneyLaunderingControl.pdf>)

tatim fitimi dhe TVSH-në, efienca tatimore është në linjë me performancën e shteteve fqinjë', por gjithsesi ka një marzh të gjerë rezultatesh.<sup>14</sup>

### Kosova

Në vitin 2009 Kosova u bë anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe nënshtroi një marrëveshje bashkëpunimi, që do të sigurote mbështetjen e Kosovës si dhe vendoste detyrimin për të plotësuar një sërë kriteresh sasiore të performancës. Me këtë marrëveshje, u miratuan ligjet për TVSH-në, të ardhurat personale dhe tatim fitimin si dhe u zhvilluan seminare në gjithë rajonet që i ndihmuan taksapaguesit të përshtateshin me ndryshimet legjislative dhe me detyrimet që vinin prej tyre.<sup>15</sup> Së bashku me instalimin e Regjistrimit Elektronik të Pagesave (ECR), që bënte të detyrueshëm regjistrimin e parasë cash elektronikisht, të ardhurat totale tatimore u rritën ndjeshëm dhe në mënyrë të qëndrueshme. Një pjesë e konsiderueshme i përket TVSH-së, pesha e të cilës u rrit në 2009-n nga 15% në 16% dhe në 2016 në 18%.<sup>16</sup>

Duke qenë se Kosova mbështetet ndjeshëm në taksat indirekte që mbledhen në kufi dhe ka vetëm 14% taksa direkte, Administrata Tatimore rekomandoi në vitin 2011 rritjen e taksave indirekte. Kjo përfshinte zgjerimin e bazës së taksapaguesve për tatim fitimin (dhe vendosjen e një tatim fitimi të sheshtë dhe rritjen e progresivitetit të tatimit mbi të ardhurat.<sup>17</sup> Të dyja këto u vendosën në 10% në 2013 dhe të ardhurat nga këto zëra shënuan rritje, duke kompensuar një rënie të lehtë si rrjedhojë e uljes

së çmimeve, që ndikuan vlerën e importeve dhe si rrjedhojë edhe të të ardhurave doganore.<sup>18</sup>

Të ardhurat në 2016-n u përmirësuan nga taksat më të larta të akcizës (cigare, alkool dhe karburante) dhe rritja e TVSH-së nga 16 në 18% atë vit,<sup>19</sup> si dhe një përqasje e re në mbledhjen e të ardhurave jo tatimore. Për shkak të performancës relativisht pozitive të ekonomisë kosovare – edhe pse jo optimale për një vend në zhvillim, të ardhurat tatimore pritet të kenë një tendencë të qëndrueshme rritjeje deri në 2020.<sup>20</sup>

### Kontributet shoqërore dhe Evazioni tatimor

Në vitin 2012 u bë gjithnjë e më fortë ideja që sistemi i mbështetjes së pensioneve dhe sigurimeve duhet të reformohet. Kosto e veteranëve të luftës së certifikuar dhe atyre të rinj mund të bëhet e papërbalueshme. Skema e pensioneve po dekurajonte gjithashtu punonjësit për të punuar.<sup>21</sup> Viti 2017 do të jetë i pari kur edhe kontributet e sigurimeve shoqërore do të jenë të detyrueshme, krahas kontributeve për pension. Kontributet e sigurimeve shoqërore janë në shumën e 7% të të ardhurave bruto të paguara në mënyrë të barabartë nga punëdhënësi dhe punëmarrësi, me 3.5% secili dhe pritet të japin një ndikim të ndjeshëm tek të ardhurat.<sup>22</sup>

<sup>14</sup> IMF-Albania taxation

<sup>15</sup> Tax Administration of Kosovo, Annual Report 2010, [http://www.atk-ks.org/ep-content/uploads/2010/09/Raporti-Vjetor-2010\\_v\\_fundit\\_shtyp\\_ENG.pdf](http://www.atk-ks.org/ep-content/uploads/2010/09/Raporti-Vjetor-2010_v_fundit_shtyp_ENG.pdf) p. 18

<sup>16</sup> Vat Live, VAT news (16.09.2015) <http://www.vatlive.com/vat-news/kosovo-raises-vat-to-18/>

<sup>17</sup> International Money Fund, Staff Report 2011 <http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2011/cr11374.pdf>

<sup>18</sup> International Money Fund, Staff Report 2013

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2013/cr13379.pdf>

<sup>19</sup> International Money Fund, Staff Report 2016,

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2016/cr1622.pdf>

<sup>20</sup> Policy Report Pension System Kosovo 2012

[http://legalpoliticalstudies.org/download/Policy\\_Report\\_06\\_2012\\_eng.pdf](http://legalpoliticalstudies.org/download/Policy_Report_06_2012_eng.pdf)

<sup>21</sup> KPMG Tax News Kosovo (21.12.2016):


<https://home.kpmg.com/al/en/home/insights/2016/12/tax-news-kosovo--new-administrative-instruction-on-the-implement.html>

<sup>22</sup> Loxha Arberesha, Group for Legal and Political Studies (06/2012) "Pension System in Kosovo: review of current state, main challenges and gaps"

[http://legalpoliticalstudies.org/download/Policy\\_Report\\_06\\_2012\\_eng.pdf](http://legalpoliticalstudies.org/download/Policy_Report_06_2012_eng.pdf)



Figura 7 – Të ardhurat nga taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore në Kosovë për periudhën (2009 - 2015). Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Administrata e Taksave të Kosovës, Ministria e Financave të Kosovës.



Nuk ka ende të dhëna të sakta për nivelin e evazionit tatimor, për shkak të sistemit ende të lartë burokratik, volumit të lartë të transaksioneve në cash dhe qytetarëve që kanë frikë të raportojnë mospagimin e taksave, për shkak se mund të humbin vendin e punës. Autoritetet po përparojnë me zhvillimin e një sistemi të centralizuar prokurimi për të gjurmuar korrupsionin, dhe për të përmirësuar qeverisjen duke i bërë shpenzimet publike dhe të ardhurat më eficiente.

Sistemi i sigurimeve shoqërore është i komplikuar. Ashtu si në rastin e Maqedonisë, sistemi i pensioneve në Kosovë përbëhet nga tre shtylla, që ndryshojnë më së shumti nga modeli i financimit dhe shtresat e popullsisë që mbulojnë:

- **Shtylla e parë** – është një skemë bazë e asistencës sociale, që aplikohet për të moshuarit. Kjo shtyllë është e integruar në Qeverinë Qendrore dhe mënyra e saj e financimit dhe e funksionimit ngjan më së shumti me skemën pay-as-you-go (PAYG) të shtyllës së parë të pensioneve të financuara nga

shteti. Shpenzimet për pension në bazë të kësaj skeme konsiderohen të jenë përfitime sociale.

- **Shtylla e dytë** – është një skemë e detyrueshme pensioni. Kjo skemë zbatohet nga gushti 2002, kur punëdhënësit e mëdhenj dhe agjencitë shtetërore e kishin të detyrueshëm pagimin e kontributeve. Që prej vitit 2003 skema e detyrueshme e kursimeve u zgjerua për të mbuluar të gjithë punëdhënësit e Kosovës dhe të vetë-punësuarit. Ndryshe nga Maqedonia, ku këto fonde menaxhohen dhe maturohen përmes strategjive konservative të investimit nga dy shoqëri private sigurimi, në Kosovë skemat e detyrueshme të pensioneve administrohen nga Trusti i Pensioneve të Kosovës (KPST). KPST administron kontributet e pensioneve që janë 10% të pagës bruto nga të dy, **punëdhënësit dhe punëmarrësit (5% + 5%)**, si dhe për të vetëpunësuarit: 10 % të të ardhurave të fituara. KPST gjithashtu i investon këto asete në instrumentet afatgjata dhe të qëndrueshme financiare.
- **Shtylla e tretë** – Është një skemë vullnetare e themeluar për ata që duan të investojnë më shumë në sigurinë e tyre sociale. Kjo skemë është opsionale për bizneset dhe institucionet e tjera financiare dhe mund të themelohet ose nga kontributi i punëdhënësve dhe punëmarrësve.<sup>23</sup>

Edhe pse normat tatimore dhe mënyra si funksionon sistemi i sigurimeve shoqërore janë të rëndësishme në luftën ndaj praktikave të evazionit, pa një zbatim të saktë dhe rritjes së ndërgjegjësimit, subjektet do të jenë të prirura të gjejnë rrugë për t'u shmangur në mënyrë që të jenë më konkurruese. Pa dyshim ekonomia e tregut është një kusht i dëshirueshëm në ekonominë tona përse kohë që njësitë ekonomike veprojnë në një mjedis me rregulla të njëjta dhe respektojnë parimet bazë të konkurrencës së drejtë. Një studim në Kosovë (2013) mbi informalitetin e bizneseve, gjeti se pothuajse

<sup>23</sup> Balkan tax report <http://www.norway-kosovo.no/NR/Balkan%20Taxation%20report.pdf>

62.7% e kompanive janë të sigurt se nëse ata vendosin që të shmangin taksat mund ta bëjnë këtë lehtësisht, pa u kapur. Është gjithashtu surprizuese që përsa i përket intensitetit të auditimeve, 37.3% e të anketuarve besojnë se ka një shans të lartë ose shumë të lartë që të kapesh nëse ke shmangur taksat.<sup>24</sup> Vlerësohet se ata mbështeten në praktikën e mirëvendosur të ekonomisë së fshehur për t'i dhënë rryshfet inspektorit të taksave. Situata është pak e a shumë e ngjashme në shtetet e tjera të Europës Juglindore (EJL).<sup>25</sup>

Mungesa e burimeve njerëzore i pengon qeveritë e EJL që të monitorojnë tatimet dhe doganat në mënyrë eficiente. Mungesa e monitorimit, ndër-lidhshmërisë dhe ndarjes së informacionit mes vendeve rrit mundësinë që oficerët e taksave dhe tatimeve të përfshihen në veprime korruptive. Këto nga ana e tyre lidhen shpesh me praktikën e ekonomisë së fshehur të njëjësive ekonomike. Ndërsa Bullgaria (aktualisht dhe në të kaluarën), Kroacia dhe Maqedonia (së fundmi) dhe Shqipëria (në plan) fokusohen tek teknologjia, Mali i Zi dhe Kosova fokusohen në rritjen e ndërgjegjësimit rreth financave publike dhe pagimit të taksave përmes fushatave të ndryshme. Këto fushata synojnë të përfshijnë publikun në një shkallë të gjerë, dhe promovojnë zbatim të butë të rregullave të integritetit. Publiku, gjithsesi, duket të jetë i ndërgjegjësuar mjaftueshëm dhe i ndjeshëm kur vjen puna te korrupsioni te zyrtarët tatimorë: një e katërta e të anketuarve në anketimin e SELDI besonin se pothuajse të gjithë zyrtarët tatimorë ishin të përfshirë në korrupsion dhe 37% mendonin

se pjesa më e madhe e tyre ishin përfshirë.<sup>26</sup> Vlerësimi i vetëm i disponueshëm i hendekut të taksave (për vitet fiskale 2011 dhe 2012), është i bazuar në vlerësimet e Ekonomisë së Fshehur të Schneider për shtetet e Ballkanit perëndimor, dhe është publikuar nga Harremi. Një raport i mëpasshëm konsultues nga Qendra AL-Tax Centre nga Shqipëria, që i ngjan të parës në metodologji, por nuk ka referencë direkte me të, ka prezantuar vlerësimin e dytë të hendekut të taksave për rajonin për vitin fiskal 2013. Maqedonia kryeson grupin me një hendek bruto të taksave prej 29.2% të PBB-së, por për shkak të diferencave në koston e zbatimit dhe mundësisë së sistemit të rimbursimit të taksave, tre shtete kryesojnë në termat e hendekut neto të taksave – Maqedonia, Mali i Zi dhe Kosova, me 25.9 % të PBB-së GDP.<sup>27</sup>

Përsa i përket administrimit të taksave, bizneset pretendojnë se ata shpesh japin rryshfet dhe inspektorët tatimorë keqpërdorin autoritetin e tyre. Në një shkallë nga 1 në 10 (1-kurrë, 10-shumë shpesh) mesatarja e bizneseve është 4.48. Ata gjithashtu besojnë se zyrtarët tatimorë abuzojnë me autoritetin e tyre (Mesatarja: 4.35, 1-kurrë, 10-gjithmonë).<sup>28</sup>

Gjithsesi, taksat e ulëta nuk nënkuptojnë rrjedhimisht një sektor më të vogël informal, sepse ka shumë faktorë të tjerë që përcaktojnë nëse firmat zgjedhin të operojnë në informalitet. Në këtë drejtim, fuqizimi i administrimit të taksave është i nevojshëm për të zgjeruar bazën e tatimore dhe për të siguruar mbledhje të vazhdueshme të taksave.

<sup>24</sup> RIINVEST Institute (2013) "To pay or not to pay – A business perspective of informality in Kosovo".

[http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/BUSINESS\\_INFORMALITY\\_5mm\\_bleed\\_no\\_inside\\_ENG\\_FINALV\\_313964385731476693005.pdf](http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/BUSINESS_INFORMALITY_5mm_bleed_no_inside_ENG_FINALV_313964385731476693005.pdf)

<sup>25</sup> SELDI (2016) "Shadow Power – Assessment of Corruption and Hidden Economy in Southeast Europe" <http://seldi.net/publications/publications/shadow-power-assessment-of-corruption-and-hidden-economy-in-southeast-europe/>

<sup>26</sup> Ibid

<sup>27</sup> Hidden economy assessment report, CSD. Also available at SELDI's hidden economy country fact sheets (2016)

<http://seldi.net/publications/publications/hidden-economy-fact-sheets-2016/>


<sup>28</sup> RIINVEST Institute (2013) "To pay or not to pay – A business perspective of informality in Kosovo". [http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/BUSINESS\\_INFORMALITY\\_5mm\\_bleed\\_no\\_inside\\_ENG\\_FINALV\\_313964385731476693005.pdf](http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/BUSINESS_INFORMALITY_5mm_bleed_no_inside_ENG_FINALV_313964385731476693005.pdf)

Thjeshtimi i procedurave, përkatësisht duke shkurtuar koston dhe kohën për të nisur një biznes, veçanërisht në nivel bashkie; Përshkrimi i procedurave dhe fuqizimi i kapaciteteve të administratës që lidhet me regjimin rregullues për të bërë biznes, veçanërisht përsa i përket licencimit të bizneseve edhe lejeve të ndërtimit janë një sërë çështjesh që kërkojnë një reagim të shpejtë nga qeveria. Kjo parashikohet në Strategjinë e Zhvillimit të SME-ve për Kosovën 2013-2017, të hartuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI).<sup>29</sup>

### 3. Rezultatet e sondazhit

Ka diferenca të mëdha mes tre shteteve kur vjen puna të dhënia e kuponit tatimor për blerjen e produkteve bazë. Në veçanti, moslëshimi i kuponit tatimor mbizotëron në Shqipëri, disi më pak në Kosovë dhe është më i ulët në Maqedoni. Në mënyrë të dukshme, produktet e kozmetikës/higjenës, alkool/cigare dhe veshje/këpucë janë më të mundshme që të shiten pa u taksuar, ndërsa ushqimet janë më të mundshmet të taksohen, veçanërisht në Maqedoni dhe Kosovë (shiko Figura 88).

Figura 8 - % e të anketuarve që thonë se ata kurrë ose rrallë kanë marrë një kupon tatimor për produktet e blera gjatë muajit të kaluar. Burimi: Sondazhi i popullatës CRPM/IDM/D4D 2016 Q.25 (popullata).




Maqedonia në 2016-n përsa i përket mos-lëshimit të kuponit tatimor për mallrat e akcizës, alkool dhe cigare (Figura 8) ka pothuajse një dyfishim nga 12% në 2014 në 20% në 2016-n. Kjo është e rëndësishme pasi mund të tregojë për humbjen e të ardhurave, inspektimet jo eficiente (veçanërisht në Administrimin Doganor), dhe kontrabandën e vazhdueshme të këtyre produkteve me taksim të lartë. Situata në Shqipëri gjithsesi duket më e rëndë dhe më e përkeqësuar se në dy shtetet e tjera, me më shumë se 50% të të anketuarve që thonë se ata kanë marrë rrallë ose nuk kanë marrë kupon tatimor për **a)** produktet e kozmetikës/higjenës, **b)** alkool/cigare, **c)** veshje/këpucë.

Gjithsesi, kur bëhet fjalë për dhënien e kuponit tatimor për shërbimet e marra, situata është e rëndë në të tre shtetet. Figura 9 tregon përqindjen mesatare të të anketuarve që thonë se ata nuk kanë marrë faturë tatimore për (disa nga) 13 shërbimet e përmendura në pyetësor. Përqindja e atyre që marrin më rrallë faturë është më e lartë në Kosovë (74%), e dyta është Shqipëria (65%) dhe e treta Maqedonia (54%).

<sup>29</sup> Ministry of Trade and Industry of Kosovo "Private Sector Development Strategy 2013-2017" (2013) [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PRIVATE\\_SECTOR\\_DEVELOPMENT\\_STRATEGY\\_2013-2017.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PRIVATE_SECTOR_DEVELOPMENT_STRATEGY_2013-2017.pdf)

Gjithsesi, ka diferenca të mëdha përsa i përket llojit të shërbimeve. Veçanërisht në Maqedoni kuponi jepet më shpesh (85%) për **a)** shërbimet profesionale (kontabilitet, psikolog, arkitekt, etj.) dhe **b)** shërbime transporti (75%); ndërsa më pak për: **a)** shërbime riparimi automjetesh; **b)** mirëmbajtje shtëpie (17%); **c)** dhënia me qira e aseteve/ambienteve (30%); **d)** shërbime vetjake 36% (parukeri, rrobaqepësi, shërbime bukurie). Në Shqipëri, kuponat tatimorë jepen më shpesh për **a)** Katering dhe shërbime restoranti (84%) dhe **b)** shërbime transporti (66%) ndërsa më pak jepen për: **a)** mirëmbajtje shtëpie (6%); **b)** riparime shtëpiake (8%); **c)** qiradhënie e aseteve dhe ambienteve (11%); **d)** shërbime kujdesi për të moshuarit dhe fëmijët (15%). Edhe në Kosovë, në mënyrë të ngjashme, kuponat jepen më shpesh për **a)** katering dhe restorant (77%) dhe **b)** shërbime transporti (47%). Shërbimet ku jepet më rrallë faturë në Kosovë janë për: **a)** riparime makinash dhe elektronike (6%); **b)** riparime shtëpie (11%); **c)** dhënia me qira e aseteve dhe pasurisë (14%); **d)** shërbime kujdesi për të moshuarit dhe fëmijët (15%).


Figura 9 - % të anketuarve që thonë se ata nuk kanë marrë fatura për blerjen e shërbimeve gjatë tre muajve të fundit. Burimi: Vrojtimi i popullatës CRPM/IDM/D4D 2016 Q.26B (popullata).



Së fundmi, kur bëhet fjalë për të blerë mallra më të mëdha (si makina, mobilie, pajisje teknike etj.),

frekuenca e lëshimit të kuponave/faturave është më e ulëta në Kosovë, me 57.1% të të anketuarve, disi më mirë në Shqipëri, me 43% të të anketuarve dhe më e mirë në Maqedoni, me vetëm 11.8% të të anketuarve (**Error! Reference source not found.**).

Figura 10 - % e të anketuarve që pohojnë se nuk kanë marrë një faturë/kupon tatimor pasi kanë blerë disa mallra dy vitet e fundit. Vrojtimi i popullatës CRPM/IDM/D4D 2016 Q.24 (popullata).



Duket se reforma e vazhdueshme fiskale në Maqedoni që nga viti 2007, ka rezultuar me forcimin e kontrollit mbi shitësit e të mirave dhe shërbimeve dhe ka rritur ndërgjegjësimin e rëndësisë së dhënies së kuponit tatimor dhe lidhjes së tij me sasinë dhe cilësinë e shërbimeve publike.

Pavarësisht diferencave në dhënien e faturave tatimore dhe pagimit të taksave për mallrat dhe shërbimet, perceptimi përsa i përket dobishmërisë së taksave nuk ndryshon në të njëjtën madhësi. Në mënyrë specifike, pjesa më e madhe e të anketuarve (veçanërisht në Shqipëri) bien dakord me deklaratën “Mospagimi i taksave e ndikon negativisht ekonominë vendase”, duke treguar se kuptohet rëndësia e taksave (Figura 11). Gjithsesi, në një mënyrë disi kontradiktore (Figura 12), 16% e të anketuarve nga Shqipëria dhe Maqedonia gjithashtu pohojnë se “Mospagimi i taksave duhet të tolerohet” (e zgjedhur më shpesh nga të anketuarit me të ardhura më të ulëta), duke treguar se megjithëse konsiderohet e rëndësishme për ekonominë lokale, morali i taksave është ende i ulët në të tre shtetet.

Figura 11

- (Mos) dakordësia me deklaratën "Taksat e papaguara ndikojnë negativisht ekonominë lokale." Vëzhgimi i popullatës CRPM/IDM/D4D 2016 Q.MK11B (popullata).





Figura 12 - (Mos) dakordësia me deklaratën "Mos pagimi i taksave duhet të tolerohet." Vëzhgimi i popullatës CRPM/IDM/D4D 2016 Q.MK11G (popullata).



#### 4. Konkluzione

Barra e taksave, një nga shumë faktorët që kontribuon të evazionit fiskal, është në plan të parë aty ku politikat publike duhet, dhe shumë shpesh janë, shënjestruar në mënyrë që të ndryshojnë një sistem që nxit angazhimin në evazionin fiskal dhe mashtrimin. Barra e taksave

lidhet jo vetëm me shumën e paguar por gjithashtu në lehtësimin e vështirësive për pagimin e taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore.

**Mos-lëshimi i kuponit tatimor dhe evazoni fiskal** në Maqedoni janë arsyeja e parë dhe e dytë që kanë çuar në parregullsitë e konstatuara nga autoritetet fiskale për periudhën 2006-2015 (PRO). Përçindja e shërbimeve për të cilat lëshohet më pak kupon tatimor është më e larta në Kosovë (74%), e dyta në Shqipëri (65%) dhe e treta në Maqedoni (54%).

Përçindja e të anketuarve që pohojnë se ata nuk kanë marrë një faturë/kupon tatimor pasi kanë blerë një produkt në Kosovë vitin e kaluar është 57.1%, Shqipëri 43%, dhe më i ulët në 11.8% të të anketuarve në Maqedoni (**Error! Reference source not found.**). Lidhur me ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e taksave që duhen paguar, rezultatet tregojnë se mesatarisht më shumë se tre të katërtat e të anketuarve në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë bien dakord se taksat e papaguara ndikojnë negativisht ekonominë lokale dhe nuk bien dakord që pagimi i taksave duhet të tolerohet.

Qeveritë e Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës duhet të vazhdojnë reformën dhe të investojnë në kapacitetet operacionale të institucioneve kryesore përgjegjëse për uljen e evazionit fiskal dhe punën e deklaruar, si Administrata Tatimore, Policia Financiare, Inspektorati i Mbikëqyrjes së Punës, veçanërisht në fushën e vlerësimit të performancës, ndërlidhjes elektronike, ndarjes së të dhënave, dhe shërbimeve elektronike për individët dhe bizneset. Siç tregon dhe kërkimi, nuk është vetëm niveli i taksave që ndikon përhapjen dhe qëllimin e evazionit fiskal dhe punës së deklaruar por gjithashtu dhe lehtësia për të bërë/formalizuar biznesin dhe lehtësia për të përmbushur procedurat administrative.

Kjo varet ndjeshëm nga përpjekjet e qeverisë për të thjeshtuar, reduktuar dhe standardizuar procedurat, veçanërisht ato që japin nxitës të paqëllimshëm për informalitetin.

**Rritja e gatishmërisë për të paguar taksat:**

Kontributet e sigurimeve shoqërore, aktualisht nuk japin kthimin e pritur nga punëdhënësit privatë dhe punonjësit dhe ky është një fakt i rëndësishëm që nxit evazionin. Ulja e normës së kontributeve shoqërore, i shoqëruar njëkohësisht me rritjen e bazës së tatimpaguesve do të ishte i dobishëm. Të dhënat nga Maqedonia sugjerojnë tashmë se reduktimi i normave për sigurimet shoqërore mund të rrisë të ardhurat, përmes një mbledhjeje më të mirë të tyre.<sup>30</sup>

Është gjithashtu e nevojshme të **rritet kapaciteti i administratës** për të kapur debitorët dhe për të mbledhur borxhet e tyre. Kjo duhet të përfshirë zbatimin e **sistemeve të menaxhimit të rrezikut** (duke inspektuar në mënyrë selektive ata që kanë ndikimin më potencial negativ), por masa më e rëndësishme do të ishte unifikimi i administratës tatimore me atë që është përgjegjëse për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore. Për më tepër, niveli i zbatimit të rregullave në të tre vendet duhet të forcohet, në mënyrë që këto efekte të ndihen.

Të tre këto shtete duhet të përmirësojnë mënyrën se si **remitancat maten dhe vlerësohen** nga autoritetet shtetërore, teksa kanalet zyrtare të transfertave (të llogaritura përmes Sistemit Ndërkombëtar të Raportimit të Transaksioneve) përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të remitancave.

Është e nevojshme të **thjeshtohen dhe reduktohen kostot e transaksioneve të lidhura me remitancat**

në mënyrë që të ulen fshehja e tyre. Dërgimi i remitancave në shtëpi është zakonisht shumë i shtrenjtë dhe regresiv. Por, ende, gjithsesi çfarëdo lloj rruge që njerëzit gjejnë për të dërguar para në shtëpi duhet të optimizohet përmes një sistemi modern financiar dhe duhet diferencim kostosh për qëllime sociale.

---

<sup>30</sup> **Shurkov, E, Mickovska R.A.**, (2014) "Hunting the Shadows – Tax Evasion Dynamics in Macedonia" Policy Brief Nr. 33, Dec. 2014.  
[http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2015/03/PolicyBrief33\\_ENG.pdf](http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2015/03/PolicyBrief33_ENG.pdf)



## 5. Tabela me tregues makroekonomikë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni

MAQEDONIA	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Treguesi (mln MKD)	FY 2006	FY 2007	FY 2008	FY 2009	FY 2010	FY 2011	FY 2012	FY 2013	FY 2014	FY 2015*
<b>Tregu i Punës</b>										
Norma e Papunësisë (%)	36.0	34.9	33.8	32.2	32.0	31.4	31.0	28.6	28.0	26.1
Norma e Papunësisë së të Rinjve (%)	59.8	57.7	56.4	55.1	53.7	55.3	53.9	51.9	53.1	47.3
Norma e Papunësisë Afat-gjatë (>12 muaj)	86.3	84.9	84.9	81.9	83.3	82.6	82.1	82.5	83.4	81.6
Produktiviteti				-3.6	2.1	1.0	-1.3	-1.6	2.0	
Forca e Punës	891,680	907,141	919,425	928,774	938,294	940,048	943,055	956,058	958,997	954,924
Shkalla e Pjesëmarrjes ne Forcat e Punës	55.1%	55.7%	56.3%	56.7%	56.9%	56.8%	56.5%	57.2%	57.3%	57.0%
Paga Mesatare Neto (MKD)	13,518	14,586	16,095	19,958	20,554	20,848	20,903	21,146	21,394	21,904
Paga Mesatare Bruto (MKD)	23,037	24,140	26,228	29,923	30,226	30,603	30,670	31,026	31,325	32,171
Paga Nominale Neto (ndryshimi vjetor %)		7.3	9.4	19.4	2.9	1.4	0.3	1.2	1.2	2.3
Paga Reale Neto (ndryshimi vjetor %)		4.6	8.0	12.4	1.0	1.2	0.2	1.1	1.0	2.6
<b>PBB, Tregtia dhe Të ardhurat</b>										
<b>PBB (Çmimet Aktuale Mln MKD)</b>	334,840	372,889	414,890	414,622	437,296	464,186	466,703	501,891	525,620	560,148
Totali i Eksporteve (Mln USD)	2,415	3,398	3,991	2,708	3,351	4,478	4,015	4,298	4,964	4,490
Totali i Importeve (Mln USD)	3,752	5,281	6,883	5,073	5,474	7,027	6,522	6,620	7,301	6,400
Shpenzimet për Konsum Final	319,975	351,065	403,225	397,304	410,328	427,192	431,883	447,970	456,372	472,845

Shpenzimet për Konsum Final të Familjeve	264,690	288,408	326,125	318,213	330,344	343,080	344,852	360,115	367,729	379,290
Shpenzimet Publike për Konsum Final	55,285	62,657	77,100	79,092	79,984	84,112	87,031	87,855	88,643	93,555
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	71,683	88,421	115,890	106,734	106,999	124,926	135,003	144,584	160,081	178,492
IHD Total (mln MKD)	21,207	31,117	25,178	8,419	9,649	21,193	8,063	14,108	12,140	10,498
IHD Total (mln EUR)	344.8	506.0	409.4	136.9	156.9	344.6	131.1	229.4	197.4	170.7
Tatimi mbi Fitimin	4,710	5,896	8,579	4,435	3,691	3,888	3,655	4,419	5,060	12,024
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	8,414	8,891	8,696	8,707	8,872	9,513	9,553	10,255	12,321	12,909
TVSH	27,240	32,962	36,174	35,178	37,694	42,223	38,468	39,835	43,859	41,694
TVSH (dogana)	26,400	34,500	43,400	32,511	34,814	41,322	41,041	37,741	38,513	44,492
Akciza	680	890	1,000	14,730	14,670	15,559	16,630	18,064	19,695	20,721
Taksat Doganore	5,600	6,400	6,400	5,409	4,760	3,779	4,066	4,255	4,222	4,843
<b>Tregu i Kredive dhe Depozitave</b>										
Norma e rritjes së Kredive (%)					7.1	8.5	5.4	6.4	10.0	9.5
Norma e rritjes së Kredive Familjare (%)					5.1	8.1	6.5	10.2	11.8	12.9
Norma e rritjes së Kredive për Sipërmarrje (%)					8.4	8.6	4.5	3.8	8.6	7.1
Norma e kredive të këqija (%)	12.9	9.3	6.8	8.1	9.9	9.5	10.3	11.7	11.5	11.3
Norma e rritjes së depozitave (%)					13.7	9.2	4.9	6.1	10.4	6.3
Depozita familjare (%)					17.4	12.0	7.2	6.7	8.9	4.1
Depozita biznesi (%)					6.4	6.1	-2.0	4.1	15.0	10.2
<b>Borxhi, Deficiti dhe Inflacioni</b>										
Borxhi Publik	30.6	23.5	20.5	23.6	24.1	27.7	33.7	34.0	38.2	38.0
Borxhi Publik (përfshirë borxhet e tjera)	33.2	25.8	23	26.2	27.2	32.0	38.3	40.3	46	46.5
Deficiti Buxhetor (%)	-0.5	0.6	-0.9	-2.6	-2.4	-2.5	-3.8	-3.8	-4.2	-3.5
Norma e Inflacionit IÇK (%)	3.2	2.3	8.3	-0.8	1.6	3.9	3.3	2.8	-0.3	-0.3
NBRM FX (mln EUR)	1,416.7	1,524.4	1,494.9	1,597.5	1,714.5	2,068.9	2,193.3	1,993.0	2,436.5	2,261.8

NOE (si % PBB)			20.1	21.0	19.6	20.0	19.2			
* Te dhënat më të fundit janë të dhjetor 2015										

SHQIPËRIA											
Treguesi (mln ALL)	FY 2006	FY 2007	FY 2008	FY 2009	FY 2010	FY 2011	FY 2012	FY 2013	FY 2014	FY 2015	Q2 2016
<b>Tregu i Punës</b>											
Norma e Papunësisë (%)	13.78	13.37	13.05	13.76	14.04	13.98	13.35	15.93	17.50	17.10	15.5
Norma e Papunësisë së të Rinjve (%)	n/a	19.8	24.7	21.9	22.5	21.9	26.0	27.2	32.5	33.2	29.9
Norma e Papunësisë Afat-gjatë (>12 muaj)	n/a	71.1	63.2	67.4	70.2	73.9	77.1	72.4	64.3	66.0	
Produktiviteti	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Forca e Punës	<b>1,084,000</b>	<b>1,082,000</b>	<b>1,041,708</b>	<b>1,052,324</b>	<b>1,064,000</b>	<b>1,089,798</b>	<b>1,101,349</b>	<b>1,059,915</b>	<b>1,067,338</b>	<b>1,122,000</b>	
Shkalla e Pjesëmarrjes ne Forcat e Punës	65.2	58.0	53.3	55.1	55.2	60.3	57.3	52.4	53.7	55.7	
Paga Mesatare Neto (ALL)							51,500	52,600	53,800	54,270	54,500
Paga Mesatare Bruto - sektori publik (ALL)	23,037	24,140	26,228	29,923	30,226	30,603	30,670	31,026	31,325	32,171	32,369
Paga Nominale Neto (ndryshimi vjetor %)	7.5	17.1	8.3	11.9	6.7	6.9	7.3	4.1	1.7	1.8	
Paga Reale Neto (ndryshimi vjetor %)	4.9	13.8	6	8.1	3	3.4	5.2	2	0.1	0	
<b>PBB, Tregtia dhe Të ardhurat</b>											
<b>PBB (Çmimet Aktuale Mln ALL)</b>	882,200	966,600	1,089,300	1,143,900	1,239,600	1,300,600	1,332,800	1,350,600	1,400,500	1,444,700	
Totali i Eksporteve	77,405	97,171	112,572	104,515	161,548	196,897	213,030	246,397	255,759	243,183	
Totali i Importeve	299,147	376,194	439,894	428,839	477,768	544,004	528,490	517,378	552,281	544,606	

Shpenzimet për Konsum Final	769,319	890,645	1,010,137	1,052,102	1,106,590	1,161,114	1,183,692	1,229,289	1,297,286	1,304,879	
Shpenzimet për Konsum Final të Familjeve	673,236	784,867	892,776	918,651	961,912	1,011,826	1,032,478	1,073,609	1,129,915	1,141,148	
Shpenzimet Publike për Konsum Final	91,875	101,163	112,163	127,085	138,312	142,733	144,541	148,850	159,788	155,941	
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	332,252	351,305	366,882	374,169	352,412	381,944	353,044	352,088	342,844	390,721	
IHD Total (mln EUR)	250.0	470.0	665.0	717.0	793.0	746	746	923	812	871	
Tatimi mbi Fitimin	22,258	21,077	18,108	17,149	17,606	19,712	16,853	15,119	21,483	24,968	
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	8,580	14,850	24,498	26,820	27,058	27,967	27,989	29,570	28,852	29,661	
TVSH total	74,268	87,771	107,094	110,062	113,998	119,189	116,533	111,940	123,847	125,783	
Akciza	22,997	28,731	32,510	33,504	38,788	40,403	36,421	38,151	40,894	39,027	
Taksat Doganore	13,991	9,848	8,660	7,929	7,274	6,850	6,118	5,797	5,852	5,796	
<b>Tregu i Kredive dhe Depozitave</b>											
Norma e rritjes së Kredive (%)	56.46	50.12	34.85	11.14	9.70	12.16	2.37	-1.23	2.20	-2.42	0.44*
Norma e rritjes së Kredive Familjare (%)	65.91	57.53	30.75	4.18	1.54	-0.15	0.50	-0.01	1.24	7.40	-.019*
Norma e rritjes së Kredive për Sipërmarrje (%)	52.90	43.25	32.96	13.81	14.66	15.35	1.82	-2.01	2.37	-6.97	2.63*
Norma e kredive të këqija (%)	3.1	3.3	6.5	10.3	13.6	18.9	22.8	23.2	22.8	17.7	21.2*
Norma e rritjes së depozitave (%)		19.76	2.84	6.88	18.54	11.46	6.34	2.08	2.88	1.01	
Depozita familjare (%)		19.76	2.86	6.86	18.54	11.46	6.34	2.08	2.88	0.83	0.92*
Depozita biznesi (%)		31.25	1.30	-14.51	24.53	-5.35	-3.78	4.71	20.36	7.00	5.35*
<b>Borxhi, Deficiti dhe Inflacioni</b>											
Borxhi Publik			51.3	55.3	54	55.7	58.2	61.7	65.9	67.4	65.9**
Borxhi Publik (përfshirë borxhet e tjera)	56.1	53.5	54.7	59.7	57.7	59.4	62.2	70.4	71.8	72.5	70.9**
Deficiti Buxhetor (%)	-3.3	-3.5	-5.5	-7.1	-3.1	-3.5	-3.4	-5.0	-5.2	-4.0	-.28**
Norma e Inflacionit IÇK	2.5	3.1	2.2	3.7	3.4	1.7	2.7	1.9	0.7	2.0	

(%)											
BoA FX (mln EUR)	1,364.9	1,455.5	1,675.0	1,646.2	1,904.8	1,912.5	1972.0	2015.0	2,192	2880.0	

KOSOVA	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Treguesi (mln EUR)	FY 2006	FY 2007	FY 2008	FY 2009	FY 2010	FY 2011	FY 2012	FY 2013	2014	2015
<b>Tregu i Punës</b>	3,120	3,461	3,883	4,070	4,402	4,815	5,059	5,327	5,568	5,727
Totali i Eksporteve	441	547	609	695	878	943	922	927	1,092	
Totali i Importeve	1,586	1,790	2,107	2,114	2,443	2,737	2,649	2,611	2,814	
Shpenzimet për Konsum Final	3,332	3,661	4,172	4,222	4,517	4,976	5,320	5,539	5,855	
Shpenzimet për Konsum Final të Familjeve	2,676	3,033	3,513	3,554	3,794	4,173	4,478	4,675	4,945	
Shpenzimet Publike për Konsum Final	656	628	660	668	722	802	842	864	910	
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	738	835	1,053	1,130	1,301	1,476	1,317	1322.6	1293.8	
IHD Total (mln EUR)		440.7	369.9	295.5	368.5	384.4	229.1	280.2	151.2	324.4
Tatimi mbi Fitimin (1,000 EUR)	9,380	3,441	4,425	8,407	583	1,798	116	162	15	1
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	29	34	44	39	44	56	60	61	67	71,716
TVSH (jo-doganore)	48	59	59	76	95	121	130	147	136	154
TVSH (Doganore)	211	255	305	328	361	419	419	412	424	457
Akciza	115.268*	129.395*	132.498*	150.69449*	157.94*	200.131*	303	301	315	361
Taksat Doganore	124	143	164	155	179	206	117.721**	120.128**	126.323**	131.391**
<b>Tregu i Kredive dhe Depozitave</b>										
Norma e rritjes së Kredive (%)			32.7	8.9	13.2	16.4	3.8	2.4	4.2	
Norma e rritjes së			40.1	22.3	25.5	17.7	6.2	3.9	12.7	

Kredive Familjare (%)										
Norma e rritjes së Kredive për Sipërmarrje (%)			30.4	4.6	8.7	12.3	3.9	2.0	2.1	
Norma e kredive të këqija (%)		4.1	3.3	4.3	5.9	5.7	7.5	8.7	8.3	
Norma e rritjes së depozitave (%)	10.47	23.67	26.4	20.82	11.0	8.6	8.3	7.5	3.6	
Depozita familjare (Mln EUR)	515.7	676.8	843	1039.7	1299.4	1490.5	1640.1	1774.4	1843.3	1964.5
Depozita biznesi			477.4	388.02	526.6	509.3	528.0	555.9	559.8	
<b>Borxhi, Deficiti dhe Inflacioni</b>										
Borxhi Publik				6.4	6.2	5.5	8.4	9.1	10.6	13.0
Borxhi Publik (përfshirë borxhet e tjera)										
Deficiti Buxhetor (%)			-0.2	-0.7	-2.6	-1.9	-2.4	-3.0	-2.2	
Norma e Inflacionit - IÇK (%)	0.6	4.4	9.4	-0.2	3.5	7.3	2.5	1.8	0.4	-0.5
CBK FX (mln EUR)	14.6	13.7	11.2	11.2	14.9	18.0	19.4	19.5	19.6	
NOE (si % PBB)										

\* Nuk përfshihen të dhënat mbi akcizën e brendshme.

\*\* Mungojnë të dhënat mbi disa taksat importi, si cigaret.